



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË
DHE INOVACIONIT PËR VITIN 2020**

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Arbërie Nagavci, Ministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Adresa: Rr.Agim Ramadani, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Ne e kemi kualifikuar opinionin e auditimit për shkak të gabimeve materiale të prezantuara në vijim:

- A1 Mos shpalosja e obligimit për blerjen e librave në shumë prej 5,266,109€, për shkak të mos dorëzimit të faturës nga ana e kontraktorit.
- A2 Mbivlerësimi i pasurive jokapitale në Qendrën e Studentëve në vlerë 236,820€.
- A3 Keqklasifikimi i shpenzimeve sipas realizimit nga kodet e gabuara nga MASHTI në vlerë 31,911.
- A4 Mbivlerësimi i shpenzimeve të subvencioneve dhe transfereve në vlerë 270,000€.
- B1 Pagesa e 32 zyrtarëve të komunitetit serb, ish pjesëtarë të "Mbrotjtjes Civile", në vlerë 135,760€, në mungesë të evidencave për vajtje-ardhje në punë.
- A5 Mbivlerësimi i pasurive të blera për shkollat në vlerë 555,675€, si rezultat i mos bartjes së tyre në regjistrat përkatës të komunave.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A6 Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjaftueshëm.
- A7 Kompensimi i komisioneve të brendshme me pagesë shtesë, brenda orarit të rregullt të punës.
- A8 Ndryshimet në sasi të paramasës së kontraktuar për kontratat për punë, jo përmes departamentit të prokurimit dhe në mungesë të aprovimit të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA) dhe projektuesit.
- A9 Nënshkrimi i kontratës me fituesin e tenderit, në mungesë të vërtetimit të ATK-së dhe Gjykatës, në formën e kërkuar sipas njoftimit nga KRPP.
- A10 Mos konfirmimi i informatave financiare para njoftimit për dhënie të kontratës.
- A11 Vazhdimi i kryerjes së punëve/projekteve, përtej afatit të kontratës dhe në mungesë të aprovimeve për zgjatje të ekzekutimit të kontratës, si dhe mungesa e programeve të kryerjes së punimeve.
- C1 Mos harmonizimi i regjistrit të inventarizimit me regjistrin e pasurive në MASHTI, si dhe mos funksionimi i e-pasurisë në shtatë programe në kuadër të MASHTI.
- B2 Përzgjedhja e fituesve të tenderëve, në mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit.
- B3 Vonesa në pagesën e faturave deri në gjashtë muaj përtej afatit të përcaktuar ligjor, në vlerë totale prej 891,984€

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se MASHTI kishte bërë pagesa nga kategoria e investimeve kapitale në shumë prej 393,952€, si dhe nga mallrat dhe shërbimet në vlerë 42,547€, si rezultat i buxhetimit të gabuar.

Përveç kësaj, MASHTI kishte bërë edhe pagesa tjera nga kategoria e investimeve kapitale në bazë të Vendimeve gjyqësore në shumë prej 60,000 për kompensimin e shtesave në pagë në mënyrë retroaktive dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore.

Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate kanë rezultuar me mbivlerësimin e kategorisë së investimeve kapitale në vlerë 453,952€ si dhe mbivlerësimin e kategorisë mallrave dhe shërbimeve në vlerë 42,547€, dhe rrjedhimisht nënvlerësimin e kategorive tjera në vlerë 496,499€.

Kjo kishte ndodhur për arsyen se : (1) me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike, dhe (2) për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, detyrimet për paga në bazë të Vendimeve gjyqësore nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit, dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera.

Duke qenë se ky problem është mjaft i përhapur edhe te organizatat tjera, më hollësisht do të trajtohet te Raporti i auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

ZKA është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKA është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (Grafiku 1) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Nënvlërësimi i obligimeve të pa paguara

Gjetja

Neni 3 i Rregullores 03/2013 për Raportimin e Obligimeve të Pa paguara thekson se obligim do të thotë marrëveshje ligjore siç është kontrata apo urdhërblerja në të cilën ka hyrë OB dhe e cila kërkon nga OB që të bëjë shpenzim.

Vlera totale e librave shkollorë që janë furnizuar dhe shpërndarë nga katër (4) shtëpitë botuese të kontraktuara për furnizimin e teksteve shkollorë për vitin 2020-21, arrinte vlerën 11,501,960€. Prej tyre, në vitin 2020 ishin paguar 6,235,851€, ndërsa pjesa tjetër e borxhit prej 5,266,109 euro, ishte mbetur për tu paguar gjatë vitit 2021. Në mungesë të faturës, ministria nuk i kishte prezantuar këto obligime në regjistrin e obligimeve, por as nuk e kishte shpalosur në pasqyra financiare si detyrim të pa paguar.

Shkaku pse OE kanë kryer furnizimet me libra, por nuk i kanë faturuar MASHTI-t, lidhet me faktin se në DNPDF, ministria për vitin 2020 ka planifikuar buxhet prej 6.23 milionë euro, ndërsa 7.02 milionë euro për vitin 2021.

Ndikimi

Pavarësisht faktit se ministria nuk ka pranuar faturë, detyrimi faktik ndaj operatorit është krijuar me rastin e kontratës dhe dorëzimit të librave. Prandaj, mos shpalosja e plotë e obligimeve në pasqyra financiare reflekton pasqyrim jo real të pozicionit financiar të ministrisë, duke i nënvlerësuar borxhet. Kjo mund të ndikojë edhe në përcaktimin e masës së pamjaftueshme buxhetore për MASHTI, për vitin pasues nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të dhënat kontabël të jenë të harmonizuara me gjendjen faktike të borxheve, dhe me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare të shpalos të gjitha transaksionet që kanë rezultuar me pranim të mallrave apo shërbimeve, dhe për të cilat pritet dalje e sigurt e parasë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësimi i pasurive jokapitale në Qendrën e Studentëve

Gjetja

Sipas rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19, pika 6, përcaktohet që të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas inventarizimit, duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

Qendra e Studentëve kishte kryer inventarizimin e pasurisë me kohë, megjithatë nuk ishte harmonizuar raporti i inventarizimit me regjistrin e pasurive jokapitale, dhe ndryshimet e identifikuar në raportin e inventarizimit nuk ishin reflektuar në e-pasuri. Vlera e pasurive sipas komisionit të inventarizimit të pasurive ishte 1,592,186€, ndërsa vlera sipas sistemit e-pasuria ishte 1,828,466€. Si rezultat, pasuritë jokapitale të prezantuara në PFV, ishin të mbivlerësuara për 236,280€.

Harmonizimi nuk kishte mundur të bëhej për shkak se disa pasuri, gjatë regjistrimit në e-pasuri ishin dyfishuar si dhe nuk ishte aplikuar zhvlerësimi për pasuritë e regjistruara në e-pasuri.

Ndikimi Mosbarazimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e e-pasurisë në QS, ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurive jokapitale dhe prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A2 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për heqjen e pasurive të dyfishuara si dhe aplikimin e zhvlerësimit të pasurive në e-pasuri në mënyrë që ky regjistër të reflektoj gjendjen reale të pasurive jokapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Keqklasifikimi i shpenzimeve sipas kodeve ekonomike

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

MASHTI, gjatë ekzekutimit të buxhetit kishte bërë pagesa nga kodet jo adekuate, në vlerë 31,911€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve si dhe investimeve kapitale, në rastet si mëposhtë:

- Pagesa në vlerë 26,550€ për blerjen e dhjetë (10) tabelave digjitale çmimi për njësi i të cilave ishte 2,655€, ishte paguar nga kodi i pajisjeve tjera nën 1000€ në vend të realizohej nga investimet kapitale, respektivisht kodi 3160;
- Pagesa në vlerë 2,155€, për kompensimin e mësimit të mbajtur në USHA Ferizaj ndaj profesorit të angazhuar për semestrin veror 2019/2020 sipas kontratës për honorar, ishte realizuar nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa do të duhej të paguhej nga pagat dhe mëditjet.
- Pagesa në vlerë 3,206€ sipas kontratës "Furnizimi dhe realizimi i IP Telefonisë dhe sistemit telefonik Voip në Qendrën e Studentëve" vlera totale e se cilës është 22,652€, ishte paguar nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa është dashur të paguhet nga kategoria e investimeve kapitale.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, blerja e tabelave digjitale nga kodi jo i duhur kishte ndodhur për shkak të kërkesës për blerje emergjente, ndësa pagesa e profesorit të angazhuar ishte si rezultat i kufizimit të numrit të mësimdhënësve dhe pa mundësisë së përfshirjes në listën e pagave. Më tutje, keq klasifikimi i pagesës në QS kishte ndodhur për shkak të tërheqjes së mjeteve nga Thesari me vendim të Qeverisë, duke bërë që shpenzimi të realizohet nga Mallrat dhe Shërbimet edhe pse ishte planifikuar tek Investimet Kapitale.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kodet joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në nën vlerësimin e disa llogarive dhe mbivlerësimin e llogarive tjera, që për efekt kanë paraqitjen e pa saktë të gjendjes së llogarive në PFV.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mbivlerësimi i shpenzimeve të Subvencioneve dhe Transfereve

Gjetja Neni 8.4 i Rregullores nr 01/2017 për Pasqyrat Financiare Vjetore të OB, lidhur me Politikën kontabël përcakton se pagesat (shpenzimet) njihen vetëm atëherë kur ato paguhen nga llogaria e vetme e Thesarit.

MASHTI, më datë 23 dhjetor të vitit 2020, kishte çertifikuar dy pagesa në vlerë totale prej 300,000€, mjete këto për mbulimin e shpenzimeve për bursat e programit Fullbright, dhe me këtë rast këto transaksione ishin regjistruar në SIMFK si pagesa të kryera. Mirëpo gjatë testimave tona, përmes krahasimit të të dhënave të BQK-së me librin e përgjithshëm të Thesarit, kemi konfirmuar se për njërin nga dy pagesat, përkatësisht pagesën në vlerë 270,000€, nuk kishte dalje të parasë në këtë shumë. Një gjë e tillë nuk ishte vërejtur as me rastin kur MASHTI kishte bërë barazimin e shpenzimeve me Thesarin në fund të vitit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Thesari nuk kishte lejuar transferin për shkak të mungesës së mjeteve likuide, dhe nuk e ka bërë shlyerjen e tyre nga libri kryesor, derisa sipas ZKF-së, ministria nuk është njoftuar për mos realizimin e pagesës. Duhet të potencohet fakti se Thesari e bën barazimin e të dhënave të SIMFK-së me të dhënat nga BQK, ndërsa ministria nuk i posedon të dhënat nga BQK. Ministria e ka kuptuar se këto pagesa nuk janë ekzekutuar, vetëm kur përfituesi është ankuar se nuk i janë paguar mjetet.

Ndikimi Regjistrimi i transaksioneve në SIMFK pa u pasuar me dalje të mjeteve nga llogaria bankare ka ndikuar që shpenzimet e subvencioneve dhe transfereve në PFV të mbivlerësohen për 270,000€

Rekomandimi A4 Ministri, në bashkëpunim me Zyrтарin Kryesor Financiar duhet të siguroj që të qartësohen me Thesarin të gjitha çështjet në lidhje me pagesat, për tu siguruar që njohja e shpenzimeve dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare të bëhet vetëm pas konfirmimit të daljeve të mjeteve nga llogaria bankare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e evidencës për vajtje - ardhjet në punë

Gjetja

Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrojta Civile” e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Në MASHTI, pas një procesi të rekrutimit me akt-emërime ishin integruar 32 nëpunës të komunitetit serb, ish pjesëtarë të “Mbrojtjes Civile”. Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpunë komunitet në pjesën veriore të Kosovës. Megjithatë, në akt-emërimet e tyre, të punësuarit janë sistemuar në pozita të caktuara brenda departamenteve përkatëse në ministri. Për këta punonjës, MASHTI, nuk ka dëshmi për ta konfirmuar paraqitjen e tyre në vendin e punës për t'i kryer detyrat për të cilat janë të ngarkuar me kontrata, përderisa ishte bërë pagesa e rregullt e pagave të tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2020, për këta 32 zyrtarë është 135,760€.

Ndonëse MASHTI kishte kërkuar nga Qeveria përkrahje lidhur me zgjidhjen e këtij problemi, kjo e fundit nuk kishte marrë ndonjë veprim. Përveç kësaj kërkesë, MASHTI nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të siguruar vijueshmërinë e këtyre zyrtarëve në vendin e punës.

Ndikimi

Pagesa e pagave për punonjës që nuk paraqiten në punë, shkakton dëmtim të buxhetit të ministrisë si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara me marrëveshje, pra integrimin e këtij komuniteti në sistemin e Republikës së Kosovës.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar vijueshmërinë e rregullt të këtyre punonjësve në vendin e punës, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mbivlerësimi i pasurive kapitale**Gjetja**

Sipas nenit 9 të rregullores Nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore (OB), transferimi i pasurive në ndonjë organizatë tjetër mund të ndodhë në rast të: delegimit të përgjegjësive si dhe konstatimit se pasuria jo financiare është e nevojshme për organizatën në fjalë. Ky proces duhet të ndodhë përmes tjetërsimit të pasurisë, me vendim të ZKA-së, në bazë të rekomandimit të komisionit për vlerësim të pasurisë jo financiare.

Pasuritë e blera për shkollat e ulëta dhe të mesme të komunave të caktuara, në vlerë 555,675€, MASHTI i kishte regjistruar në regjistrin kontabël si pasuri në përdorim, të cilat kishin filluar edhe të zhvlerësoheshin, ndërsa nuk i kishte bartur ato tek komunat përkatëse, të cilat do të duhej t'i regjistronin në regjistrat e tyre të pasurisë, si dhe t'i raportonin në pasqyrat e tyre financiare.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos zbatimit të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare nga zyrtarët përgjegjës të MASHTI.

Ndikimi

Regjistrimi i këtyre pasurive si pasuri në përdorim dhe mos bartja e tyre në regjistrat e komunave përkatëse, ka ndikuar që vlera e pasurive të mbivlerësohet. Kjo, po ashtu, ndikon në menaxhim jo të mirë të këtyre pasurive, pasi duke qenë në pronësi të shkollave, ato nuk janë nën kontroll të MASHTI, por të komunës përkatëse. Kjo ka ndikuar që MASHTI të raportoj pasuri të cilat në fakt nuk i posedon.

Rekomandimi A5

Ministri, duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, të barten në regjistrat e komunave të cilat i kanë nën administrim këto shkolla, si dhe bartja e pronësisë të bëhet me të gjitha procedurat formale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A6 - Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjaftueshëm

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare 01/2013, neni 15, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak dhe se zotimi duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës.

Në katër raste të testuara, kemi vërejtur se Qendra e Studenteve kishte nënshkruar kontratat për punë afatshkurtëra pa zotim të mjaftueshëm të fondeve. Vlera totale e kontratave të nënshkruara ishte 617,164€ derisa zotimi i mjeteve për to ishte vetëm 130,000€ ose rreth 20% të vlerës së kontratës.

Tek procedura e prokurimit për projektin "Demolimi dhe pastrimi i tërë sipërfaqës së kulmit, bazamentin e ullukave, mbrojtëset e borës" në vlerë 68,141€, ndërsa zotimi ishte bërë në vlerë 15,000€,

Tek procedura e prokurimit për projektin "Instalimi i gypave të ujit sanitar nga ngrohja deri te konvikti nr.4 dhe 5" në vlerë 223,486€ ndërsa zotimi ishte bërë në vlerë 45,000€

Tek procedura e prokurimit për projektin "Renovimi i nyjeve sanitare në konviket 2 dhe 4, zotimi i mjeteve ishte bërë në vlerën 70,000€, ndërsa kontratat kishin vlerën 157,714€ dhe 167,823€.

Sipas shpjegimeve të QS kjo kishte ndodhur për shkak të problemeve me planifikimin e buxhetit në afatet e duhura kohore, duke mos ditur se si do të shkojnë alokimet në vazhdim dhe ekzekutimi i buxhetit për vitin 2020.

Ndikimi

Hyrja në obligime kontraktuese pa zotim të fondeve të mjaftueshme rritë pasigurinë e financimit të projekteve, dhe rrjedhimisht edhe mos përfundimin e tyre me kohë. Kjo, edhe mund të rrisë rrezikun e padive gjyqësore dhe kostove shtesë të kontratave.

Rekomandimi A6

Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj se asnjë kontratë e cila ka për qëllim realizimin e saj brenda vitit fiskal, nuk do të nënshkruhet pa siguruar zotimin e mjaftueshëm të fondeve për realizimin e saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Kompensim shtesë i komisioneve të brendshme për punë brenda orarit

Gjetja

Sipas neni 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike nuk lejohet kompensimi shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

Ne kemi vërejtur se në tetë raste, në Administratën e MASHTI, anëtarët e komisioneve të ndryshme ishin kompensuar me pagesë shtesë, derisa takimet i kishin mbajtur gjatë orarit të rregullt të punës. Pra, nuk kishte dëshmi se anëtarët e këtyre komisioneve kishin punuar jashtë orarit të rregullt të punës, andaj nuk do të duhej të merrnin kompensime shtesë. Vlera e kompensimeve për anëtarët e komisioneve për vitin 2020 ishte 5,617€. Këto komisione ishin emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministri.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kërkesat për kompensime ishin thirrur në punë shtesë, ndërsa nuk ishin marrë parasysh ndalesat ligjore për këto lloje të kompensimeve.

- Ndikimi** Pagesat e realizuara ndaj punonjësve nuk janë të mbështetura me bazë ligjore, dhe si të tilla, mund ta dëmtojnë buxhetin e ministrisë për vlerën e shpenzuar.
- Rekomandimi A7** Ministri duhet të siguroj se nuk do të paguhen kompensimet për stafin e brendshëm të angazhuar në grupe punuese dhe komisione, përderisa angazhimet kryhen brenda orarit të rregullt të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Ndryshimet në sasi të paramasës për kontratat jokornizë, pa aprovimet paraprake

- Gjetja** Bazuar në rregullat dhe udhëzuesin për prokurimin publik, nenit 61.21, ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit. Më tutje, neni 61.22 dhe 61.23 theksojnë se aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit, si dhe ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Gjatë testimit të pagesave për investime kapitale, kemi vërejtur se:

- Tek projekti “Ndërtimi I Fakultetit të Arteve faza III”, në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” në vlerë 634,895€, kishte ndryshime të sasive të realizuara në 18 pozicione të kontratës. Ndonëse vlera totale e kontratës nuk kishte ndryshuar, pozicione të caktuara ishin rritur deri në 113% më shumë nga sasia e kontraktuar. Ndërkaq, kishte mos realizim në shume pozicione, ku në total vlera e pa realizuar e pozicioneve të kontraktuara ishte 93,341€. Këto ndryshime nuk kishin kaluar përmes departamentit të prokurimit dhe nuk ishin aprovuar nga ZKA dhe as nga projektuesi. Ndryshimet ishin të aprovuara vetëm nga menaxheri i projektit me kërkesë të punë kryesit, përderisa këto aprovime nuk përmbanin datë të kërkesës apo të aprovimit.
- Tek projekti “Renovimi i sallave mësimore” në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka” në vlerë 45,952€, kishte rritje të sasive të realizuara në 57 pozicione të kontraktuara, ndërsa zvogëlim të sasive në 49 pozicione tjera. Dy pozicione nuk ishin realizuar fare. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, vlera totale e kontratës nuk kishte ndryshuar. Këto ndryshime nuk ishin evidentuar nga mbikqyrësi i projektit, e rrjedhimisht as nuk ishin aprovuar nga ZKA dhe nga projektuesi. Gjatë realizimit të projektit, dy salla të planifikuara me kontratë për renovim, nuk ishin realizuar ndërsa punët e planifikuara në këto salla, ishin zëvendësuar për renovimin e dy sallave tjera, ndonëse këto të fundit nuk ishin në plan të renovohen. Mos realizimi i renovimit të sallave të planifikuara kishte ndodhur pasi njëra nga ato ishte renovuar përmes një donacioni ndërsa tjetra kishte qenë e zënë me inventar të bibliotekës.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e mos planifikimit të mirëfilltë të projekteve dhe mos funksionimit të kontrolleve të duhura lidhur me mbikëqyrjen e këtyre projekteve.

Ndikimi

Ndryshimi i paramasës së projektuar dhe të kontraktuar në mungesë të aprovimeve të duhura dhe dëshmime se janë bërë analiza specifike për këto ndryshime, rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë konform kërkesave të projektit dhe mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar. Veprimet e tilla diskriminojnë operatorët tjerë të cilët nuk e kanë fituar tenderin për shkakun se kanë ofruar çmime të ndryshme për çdo pozicion të veçant pune.

Rekomandimi A8

Ministri, në bashkëpunim me Rektorët e Universitetit të Pejës dhe Universitetit të Gjilanit, duhet t'i shqyrtojnë rastet e mësipërme dhe të parandalojnë rastet tjera që paramasat dhe pozicionet e punimeve të ndryshohen pa aprovimet e kërkuara sipas rregullave dhe procedurave të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Nënshkrimi i kontratës në mungesë të vërtetimit të ATK-së dhe Gjykatës.**Gjetja**

Në dosjen e tenderit “Renovimi i nyjeve sanitare në konviktin nr.2”, kontratë e nënshkruar në vlerë 167,823€ tek kërkesat e përshtatshmërisë, nga OE të propozuar për nënshkrim të kontratës është kërkuar që para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës të sigurohen:

- Vërtetimi i ATK-së, që OE nuk ka obligime të tatimeve; dhe
- Vërtetimi nga gjykata kompetente se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm.

Më tutje, në njoftimin e KRPP-së, të nxjerrë me datë 30.03.2020, për të gjitha autoritetet kontraktuese (AK) dhe operatorët ekonomik (OE), në rast të kërimit të këtyre dy dokumenteve në dosje të tenderit, janë krijuar lehtësitë si në vijim:

- Nëse është e pamundur të nxjerret Vërtetimi nga Gjykata, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, si evidencë të mjaftueshme mund të dërgoj në AK një Deklaratë me shkrim nën Betim, përmes sistemit elektronik të prokurimit publik, duke potencuar arsyet objektive për pamundësinë e sjelljes së dëshmisë në fjalë.
- Ndërsa Vërtetimi I ATK-së, nëse nuk mund të sigurohet në formë fizike, OE mund ta dorëzojë dokumentin të cilin mund ta shkarkojë nga sistemi elektronik i ATK-së.

OE i shpërblyer me kontratë, nuk kishte sjellur dokumentet e kërkuara, siç është vërtetimi nga ATK (në formë elektronike) dhe deklarata nën betim me arsyet objektive për pamundësinë e sjelljes së vërtetimit nga Gjykata sipas njoftimit të KRPP-së, dhe pavarësisht kësaj, Qendra e Studentëve kishte lidhur kontratë me OE fitues.

Dokumenti i ATK-së, ishte sjellur tre muaj pas nënshkrimit të kontratës, ndërsa vërtetimi nga gjykata kompetente ishte sjellur gjashtë muaj pas nënshkrimit të kontratës, përkatësisht në nëntor të vitit 2020.

Kjo ka ndodhur si rezultat i pakujdesisë nga zyra e prokurimit për të kërkuar dokumentet e kërkuara në formën e mundësuar sipas njoftimit nga KRPP.

Ndikimi

Nënshkrimi i kontratës në mungesë të dokumenteve që dëshmojnë se OE nuk është në obligime tatimore dhe se nuk është në falimentim, rritë rrezikun e shkeljes së rregulloreve të prokurimit dhe dhënien e kontratave operatorëve ligjrisht të pa përgjegjshëm.

Rekomandimi A9

Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj që kontratat duhet të nënshkruhet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë së tenderëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Mos konfirmimi i informatave financiare para njoftimit për dhënie të kontratës.**Gjetja**

Neni 8.7 i RrUOPP si dhe neni 3 i deklaratës së nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, kërkon që të plotësohet para publikimit të dhënies së kontratës, nga personat e autorizuar me qëllim të rikonfirmimit se informatat financiare nuk kane ndryshuar materialisht.

Në shtatë kontrata të nënshkuara, kemi vërejtur se nuk ishte bërë rikonfirmimi i informatave financiare në deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së mjeteve (DNPDM) në kohën e duhur, e që është para njoftimit për dhënie të kontratës, si në vijim:

Lidhur me procedurën "Furnizimi me mjete laboratorike për arsimin parauniversitar," në vlerë 1,100,000,0€, DNPDM ishte shqyrtuar gati tre muaj e gjysme para njoftimit për dhënie të kontratës, madje edhe para njoftimit për kontratë. Derisa, shqyrtimi i kësaj deklarate bëhet me qëllim që të konfirmohet se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht, në këtë rast kjo nuk është e vlefshme, pasi shuma prej 250,000€ e planifikuar të shpenzohet gjatë vitit 2020, nuk mund të realizohet duke qenë se kontrata është e nënshkruar me 31.12.2020

Rikonfirmimi i informatave financiare në DNPDM, nuk ishte bërë para njoftimit të dhënies së kontratës, as për projektet, si: "Vazhdimi I punëve në shkollën e muzikës në Gjilan" në vlerë 547,141€ "Instalimi i gypave të ujit sanitar nga ngrohtorja deri te konvikti nr.4 dhe nr.5" në vlerë 223,485€; "Demolimi dhe pastrimi i tërë sipërfaqes së kulmit" në vlerë 68,140eur; "Renovimi i nyjeve sanitare në konviktin 2 dhe 4"; "Ndërtimi i shkollës së mesme në Ferizaj" në vlerë 767,153€; si dhe "Ndërtimi i sallës së sportit në Vushtrri në vlerë 237,495€".

Nënshkrimi i pjesës së rikonfirmimit të informatave financiare në datën e njejtë me datën e aprovimit të inicimit të procedurës nga ZKA, sipas zyrtarëve përgjegjës kishte ndodhur me qëllim të përshpejtitimit në plotësimin e dokumentacionit për shkak të reduktimit të stafit për shkak të pandemisë.

Ndikimi

Mos konfirmimi i informatave financiare në kohën e duhur në DNPDM, ndikon në hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve të mjaftueshme buxhetore, duke rrezikuar kështu edhe realizimin e kontratave, dhe ndërprerjen e punimeve nga kontraktuesit.

Rekomandimi A10

Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që para nënshkrimit të kontratave, të sigurohet se ka fonde të mjaftueshme në pajtim me ndarjet buxhetore, dhe se informatat financiare në DNPDM, duhet të ri-konfirmohen para publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Mangësitë në menaxhimin e kontratave për punë**Gjetja**

Sipas nenit 17 të kushteve të përgjithshme të kontratës dhe pjesës III të kontratës, të KVK pika 12.1, kontraktuesi do të kryej punët në pajtim me programin e dorëzuar nga kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e menaxherit të projektit, dhe do të plotësoj ato brenda nje afati të caktuar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Më tutje, Neni 18.2 I kontratës, thekson se brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, kontraktuesi duhet të lajmërojë Autoritetin Kontraktues (AK) se ka qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit, dhe më pas AK, brenda 30 ditësh do t'i përgjigjet me shkrim kësaj kërkesë nëse mund të arsyetohet.

Në shtatë kontrata të testuara*, kemi vërejtur se nuk është siguruar programi për punët apo plani i detajuar i punëve që do të kryhen nga kontraktuesi, gjatë periudhës së realizimit të kontratës. Ndërsa, planet e menaxhimit, nuk përmbajnë informata të mjaftueshme lidhur me realizimin e kontratave. Po ashtu, ishte tejkaluar afati i përcaktuar në kontratë për kryerjen e punimeve, pa aprovimin e AK.

Gjatë testimit të pagesës në vlerë 20,866€ sipas kontratës “Ndërtimi i shkollës së mesme profesionale në Ferizaj” në vlerë 665,442€, kemi vërejtur se afati për përfundimin e punëve/kontratës ishte në korrik 2020, mirëpo punët në këtë projekt ende nuk kishin përfunduar. Përveç kësaj, nuk kishte kërkesë për zgjatje të periudhës së ekzekutimit dhe as aprovim nga ana e ministrisë, përmes të cilës vërtetohet zgjatja e afatit të kontratës.

Gjatë testimit të pagesës në vlerë 111,852€ sipas kontratës “Ndërtimi i shkollës në Vraniq, Suharekë” në vlerë 1,182,931€, si dhe ekzaminimit fizik të kësaj shkolle, kemi vërejtur se ka vonesë në kryerjen e punimeve, por këto vonesa nuk janë raportuar apo arsyetuar nga menaxheri i kontratës.

Gjatë testimit të pagesës në vlerë 97,891€ sipas kontratës “Ndërtimi i Fakultetit të Arteve faza III”, në vlerë 634,895€ në Universitetin Haxhi Zeka në Pejë, afati për përfundimin e punimeve, duke përfshirë aneks kontrata për punë shtesë, ishte deri më 20.12.2019, ndërsa situacioni përfundimtar së bashku me punët shtesë ishin kryer me 17.11.2020. Sipas menaxherit të projektit, plani dinamik i ofruar fillimisht nuk ishte i vlefshëm për shkak se kontrata ishte nënshkruar në një afat më të shtyrë, megjithatë ky arsyetim nuk është në harmoni me afatet e përcaktuara në kontratën bazë dhe aneksin e punëve shtesë.

Sipas menaxherit të projektit, vonesat në punime kishin ndodhur si pasojë e vonesave në lëshimin e lejes së ndërtimit, ndërsa në vitin 2020 për shkak të pandemisë, dhe se nuk kishin qenë të informuar se zgjatja e afatit të ekzekutimit të punimeve/kontratës, duhet të aprovohet nga AK përmes dokumenteve përkatëse.

Më tutje, mungesa e planeve të detajuara ishte si pasojë e neglizhencës nga menaxherët e projekteve për t'i kërkuar ato.

Ndikimi Mungesa e planeve të detajuara apo programeve të punëve ndikon në mos identifikimin dhe mos raportimin e vonesave të punëkryesit përbrenda periudhës së realizimit të kontratës. Vonesat në realizim të kontratave, pas përfundimit të afatit të kontraktuar, pa ndonjë afat të miratuar për zgjatje, përveç se në vonesën e shfrytëzimit të këtyre projekteve/pasurive nga ana e qytetarëve, gjithashtu rëndojnë buxhetin e projekteve të viteve vijuese, duke mos përcaktuar një afat të qartë të kryerjes së projektit.

Rekomandimi A11 Ministri, duhet të siguroj një mbikëqyrje më strikte ndaj realizimit të projekteve, duke kërkuar që për çdo kontratë të raportohet rregullisht ecuria e realizimit të projektit në përputhje me planin detal dhe në rast të zgjatjes së periudhës së realizimit, kjo të bëhet vetëm me aprovimet përkatëse me shkrim ku definohen afatet e qarta të përfundimit të projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos kryerja me kohë e procesit të inventarizimit

Gjetja Sipas rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19, përcaktohet që raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Ndërsa, neni 6, pika 3 e rregullores përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

MASHTI, nuk kishte arritur të kryej procesin e inventarizimit para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, dhe rrjedhimisht nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare.

Në shtatë programe* në kuadër të MASHTI, pasuritë jokapitale janë raportuar përmes regjistrave në excel, dhe jo sipas e-pasurisë për shkak të mos përdorimit të saj. Në pesë prej tyre, pasuria është paraqitur në vlerën origjinale të blerjes dhe jo në vlerën neto. Vlera e përgjithshme e këtyre pasurive, e paraqitur në PFV është 1,182,098€.

Mangësitë e identifikuarra ishin si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve në fushën e menaxhimit të pasurive.

Ndikimi Mos kryerja e inventarizimit sipas kërkesave të rregullores në fuqi, si dhe mos përdorimi i sistemit e-pasuria në programe të caktuara, ndikon që vlera e pasurive në pasqyra financiare të mos raportohet e saktë dhe e plotë.

Rekomandimi C1 Ministri, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit të përfundoj me kohë, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, dhe të bëhet krahasimi mes gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë, si dhe të gjitha pasuritë jokapitale të regjistrohen dhe raportohen përmes sistemit e-pasuria, në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mangësitë në procesin e vlerësimit të ofertave për procedurat e prokurimit

Gjetja

Nga nëntë procedura të prokurimit të testuara në fushën e investimeve kapitale, në katër prej tyre kemi vërejtur mangësitë gjatë procesit të vlerësimit, si në vijim:

Në dosjen e tenderit në procedurën e prokurimit për “Ndërtimin e shkollës së mesme në Ferizaj” në vlerë 767,153€, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar që të sigurohen dëshmitë si në vijim:

- Lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale për: nëse konkurren për një Lot duhet të jetë 1,500,000,€; dhe nëse konkurren për dy Lote duhet të jetë 3,000,000€.

OE fitues nuk kishte sjellur referenca të mjaftueshme siç janë kërkuar, ndonëse kishte aplikuar për dy lote. Vlera e referencave të ofruara ishte 593,826€. Në këtë rast komisioni përveç referencave, kishte marrë në konsideratë edhe pranimet teknike të punëve të përfunduara nga OE fitues, mirëpo përsëri nuk përmbushej kriteri i kërkuar pasi që vlera e punëve të përfunduara sipas referencave së bashku me pranimet teknike, në total arrin vlerën 1,985,213€.

Në dosjen e tenderit për “Furnizim me pajisje të TI-së” në Universitetin e Pejës, ku kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 14,760€, tek kërkesat e kapacitetit ekonomik, është kërkuar që operatori ekonomik (OE) të dorëzoj:

- Pasqyrat financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit, apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

OE fitues, nuk kishte ofruar pasqyrat financiare, por vetëm qarkullimin financiar bankar.

Duke pasur parasysh se përmes dokumenteve si deklaratat vjetore tatimore apo pasqyrat financiare, vërtetohet pozita e saktë financiare e kompanisë, përkatësisht të hyrat dhe shpenzimet e sakta, vlerësojmë se Universiteti është dashur të kërkojë informata sqaruese.

Në dosjen e tenderit “Renovimi i nyjeve sanitare në konviktin nr.2”, ku kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 167,823€, tek kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional, është potencuar se OE duhet të dëshmoj se ka të angazhuar (ose do t'i angazhoj) së paku 15 punëtorë (dhe të ofrojë si dëshmi listën e punëtorëve).

Listat e ofruara të punëtorëve nga OE i shpërblyer me kontratë, ishin dokumente të vitit 2017 si dhe nuk e përmbushnin numrin e kërkuar prej 15 punëtorëve.

Në dosjen e tenderit për “Renovimin e nyjeve sanitare në konviktin nr.4”, ku kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 157,714€, tek kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare është kërkuar që OE të dorëzoj dokumentet nga banka për qarkullimin e OE në tri vitet e fundit, ose pasqyrat e audituara financiare për tri vitet e fundit ose deklaratat vjetore tatimore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit, deri në datën e njoftimit për kontratë.

OE fitues kishte ofruar deklaratat vjetore tatimore për vitet 2016-2018, duke mos përfshirë vitin e fundit (2019) siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e pa kujdesisë apo mos kompetencës së komisioneve të vlerësimit, për t'i vlerësuar me kujdes ofertat dhe për t'i analizuar dëshmitë e ofruara në raport me kriteret e përcaktuara, si dhe mos aplikimi i kërkesës për sqarim në rastet kur këto kërkesa mund të aplikohen.

Ndikimi

Vlerësimi jo i duhur i ofertave, posaçërisht në rastet e cekura të mos përmbushjes së kriterit për të dëshmuar në mënyrën e duhur kapacitetin ekonomik dhe financiar, rrezikon që OE fitues të mos jenë në gjendje të përfundojnë me sukses projektet e fituara, si shkak i mungesës së kapacitetit ekonomik dhe financiar.

Rekomandimi B2

Ministri në bashkëpunim me Rektorin e Universitetit të Pejës dhe Drejtorin e Qendrës së Studentëve duhet të sigurojnë se vlerësimi i tenderëve bëhet në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja

Sipas nenit 17.1 të Rregullores 01/2017 për PFV të OB, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë, për mallrat dhe shërbimet e furnizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë testimit të dy pagesave për investime kapitale, sipas kontratës "Blerja e licencave të pakos softuerike Gjuha Shqipe dhe Kompjuteri", kemi vërejtur se fatura në vlerë 608,000€ ishte paguar gjashtë muaj pas datës së pranimit të faturës, ndërsa fatura në vlerë 261,986€, ishte paguar katër muaj pas datës së pranimit.

Gjatë testimit të faturave të papaguara, fatura në vlerë 21,998€ sipas kontratës "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike Anton Çeta - Skenderaj", ishte në vonesë për më shumë se 30 ditë nga data e pranimit të faturës.

Vonesa në pagesën e faturave të pakos softuerike kishte ndodhur si rezultat i vonesës në krijimin e komisionit për vlerësimin e shërbimeve të pranuar nga kjo kontratë, përderisa vonesat në pagesën e obligimeve kryesisht kishin ndodhur për shkak të kontrolleve jo të mira sa i përket pagesës së faturave, duke u arsyetuar me mungesë buxheti.

Ndikimi

Vonesat në pagesa mund të krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga dhe Mëditje është 19,275,334€ dhe realizimi 19,162,565€, apo 99%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,267 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,220. Gjatë vitit 2020 ishin punësuar 42 punonjës të rinj. Kemi testuar 92 mostra për teste substanciale në vlerë 206,619€, si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Kompensim i komisioneve të brendshme në kundërshtim me kërkesat ligjore

Gjetja

Sipas nenit 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike nuk lejohet kompensimi shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

Katër nga gjashtë Universitetet në kuadër të MASHTI me aprovim të Këshillit Drejtues kishin përfshirë në rregulloret e tyre të brendshme kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa lloje të komisioneve. Komisionet e tilla ishin për pjesëmarrje në hapje dhe vlerësimin e ofertave të prokurimit, regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, planifikimin e buxhetit, pranimin e studentëve të rinj, për ankesa dhe parashtresa, rekrutim të stafit, ndarjen e bursave, hartimin e strategjive dhe rregulloreve mbështetëse.

Ne vlerësojmë se disa pika të këtyre rregulloreve bien ndesh me kornizën ligjore për menaxhimin e financave publike, respektivisht janë në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, pasi që angazhimi në punë gjatë orarit të rregullt do të duhej të jetë pjesë e pandashme e detyrave të punës për të cilën punonjësit e marrin pagën bazë.

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, tri Universitete ende nuk kanë ndërmarrë veprime për plotësim ndryshimin e rregulloreve për kompensimin e komisioneve të brendshme. Universiteti i Prizrenit me vendim të KD me datën 03.11.2020, kishte bërë plotësimin dhe ndryshimin e rregullores, mirëpo nuk kishte shfuqizuar të gjitha nenet të cilat parashohin kompensimet e komisioneve.

Gjatë testimit të mostrave në lidhje me kompensimet shtesë kemi vërejtur rastet si në vijim:

- Nga mostrat e testuara në Universitetin “Ukshin Hoti”-Prizren, kemi vërejtur se punonjësit ishin kompensuar për pjesëmarrje në komisionin për inventarizimin e pasurive, pranimin e studentëve të rinj, për ankesa dhe parashtrës, rekrutim të stafit, Komisioni për pranimin e donacioneve, për vlerësimin e ofertave, derisa takimet i kishin mbajtur gjatë orarit të rregullt të punës. Vlera e kompensimeve shtesë për anëtarët e komisionit për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor ishte 3,780€.

Nga mostrat e testuara në Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan, kemi vërejtur se punonjësit ishin kompensuar për pjesëmarrje në komisionin për hartimin e rregulloreve derisa takimet i kishte mbajtur gjatë orarit të rregullt të punës. Vlera e kompensimeve shtesë për anëtarët e këtij komisioni për muajin korrik, tetor, nëntor dhe dhjetor ishte 3,295€

Shkaku i mos ndryshimit të rregulloreve ishte se Universitetet ishin në pritje të marrjes së iniciativës nga ana e MASHTI që në nivel të Universiteteve të bëhet rishikimi i rregulloreve.

Ndikimi

Kompensimet shtesë për shërbimet që janë pjesë e detyrave të obligueshme të pozitës të cilin e mban punonjësi nuk janë të mbështetura me bazë ligjore, dhe si të tilla mund ta dëmtojnë buxhetin e Universiteteve përkatëse, për vlerën e shpenzuar.

Rekomandimi B4

Ministri përmes mekanizmave përkatës ligjor në dispozicion duhet të inicioj rishikimin e rregulloreve të universiteteve për kompensimin e komisioneve të brendshme në mënyrë që ato të jetë në harmoni me normat e përgjithshme ligjore të menaxhimit të financave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2020 ishte 19,160,617€, prej tyre ishin shpenzuar 15,249,455€ . Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e librave për arsimin fillor si projekti me i madh i Ministrisë , shërbime kontraktuese tjera, shpenzime te ushqimit dhe mirëmbajtjes për Qendrën e Studenteve etj. Kemi testuar 65 mostra për teste substanciale në vlerë 4,139,557€ si dhe shtate (7) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në 19 pagesa të testuara të mallrave dhe shërbimeve, kemi vërejtur se urdhërblerja e shpesh herë edhe zotimi i mjeteve ishin bërë pas pranimit të faturës dhe pranimit të mallit. Pagesat kishin të bënin me: blerjen e librave, furnizime me maska për shkolla, shërbime kontraktuese tjera, furnizim me inventar, furnizim me ushqim dhe mirëmbajtje të objekteve.

Kjo praktikë ishte raportuar edhe në Raportin e Auditimit për vitin 2019 dhe si e tillë po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B5 Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve dhe Rektorët e Universiteteve, duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojnë zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A12 - Tejkallim i porosive për artikuj të kontraktuar

Gjetja Neni 56.10 i RrUOPP parasheh se sasia e parashikuar, e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhërblerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Llote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Në pagesën në vlerë 11,600€, për kontratën “Furnizim me mjete didaktike për nevojat e shkollave speciale të MASHTI-t” ku vlera totale indikative e kontratës ishte 95,985€ (për periudhën 2017-2019), kemi identifikuar se në pozicionin “72 - Fasiklla letre”, sasia e kontraktuar ishte 5,000 copë ndërsa sasi të e faturuara dhe të paguara vetëm në këtë pagesë ishin 35,600 copë apo 448% mbi normën e lejuar për kontratat publike kornizë.

Kjo kontratë ishte përmbyllur dhe në total nuk kishte tejkallim në shumën e kontraktuar mirëpo përmes Menaxherit të Kontratës kemi konfirmuar se nga 145 artikuj të kontraktuar, 71 prej artikujve nuk ishin porositur asnjëherë, ndërsa 18 artikuj e kishin kaluar normën mbi 30%, psh. artikulli 47-“Ngjyra druri (set 1/24)” 2,028% tejkallim apo artikulli 46-Ngjyra druri, (set 1/18) 794% tejkallim.

Ky tejkallim kishte ardhur si shkak i mungesës se njohurive dhe aplikimit të mospërputhjes vetëm në vlerën totale të kontratës.

Ndikimi

Tejkallimi i artikujve të kontraktuar mbi normën e lejuar mund të ndikojë që organizata buxhetore të hyjë në obligime financiare të pa planifikuara.

Rekomandimi A12

Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkallimet e furnizimeve. Në rastet kur tejkallimi i porosive për artikuj arrin shkallën 30% mbi sasi të indikative, kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale ishte 20,732,316€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 15,808,800€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për ndërtimin e objekteve arsimore, pajisjeve të teknologjisë informative, softuer, blerja e inventarit dhe pajisjeve laboratorike si dhe blerja e pajisjeve për salla sportive. Kemi testuar gjashtë 44 mostra për teste substanciale në vlerë 3,808,895€ si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A13 - Sigurimi i ekzekutimit jo në harmoni me kërkesat ligjore

Gjetja Bazuar në rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 30, Siguria e Ekzekutimit është paraparë të mbështesë përmbushjen e kontratës, dhe mbetet valide për një periudhë prej 30 ditë pas kompletimit të kontratës.

Gjatë testimit të aktiviteteve të prokurimit, në dy raste kemi identifikuar se sigurimi i ekzekutimit nuk mbulonte kohëzgjatjen e kontratës.

Kontrata “Vazhdimi i punëve në shkollën e muzikës” në Gjilan në vlerë 547,141€, si dhe kontrata Ndërtimi i çerdhes ” në Prizren, në vlerë 512,769€; ishin lidhur për periudha tre vjeçare ndërsa Operatorët Ekonomik (OE) në momentin e nënshkrimit të kontratës, kishin ofruar sigurinë e ekzekutimit vetëm për një vit.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve të prokurimit, në evidentimin e këtyre lëshimeve. Vlen të theksohet se këto mangësi ishin hasur edhe në auditimet e viteve paraprake. Pas identifikimit dhe raportimit të kësaj mangësie tek zyrtarët përgjegjës të prokurimit, të njëjtit kanë marrë masa duke na ofruar më pas sigurinë e ekzekutimit me afat të zgjatur nga operatorët ekonomik përkatës për dy kontratat në fjalë, duke mbuluar kohëzgjatjen e kontratës.

Ndikimi Ofrimi i sigurimit të ekzekutimit të kontratës për periudhë më të shkurtër se sa kohëzgjatja e realizimit të projekteve deri në pranimin final të punimeve, pamundëson ndëshkimin eventual ndaj operatorëve në rastet kur kontrata nuk përmbushet.

Rekomandimi A13 Ministri, duhet të siguroj se zyra e prokurimit, shqyrton me përpikëri përmbushjen e kërkesave nga operatorët ekonomik, me rastin e nënshkrimit të kontratave, duke u siguruar që siguria e ekzekutimit e mbulon tërë kohëzgjatjen e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Çështja A14 - Mos respektimi i parimit për ndarje të detyrave

Gjetja Sipas nenit 62.3.4 të RrUOPP, "Një zyrtar nga njësia e kërkeses i cili ka përgatitur specifikimet nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit"

Gjatë testimit të procedurave të tenderimit për projektet: "Ndërtimi i sallës së sportit në Vushtrri" me vlerë 237,496€, "Renovimi i nyjeve sanitare për konviktet 2" në vlerë 167,823€ dhe "Renovimi i nyjeve sanitare për konviktin nr.4" në vlerë 157,714€, si dhe "Furnizim me Pajisje Laboratorike për Arsimin Parauniversitar" në vlerë 1,100,000€, zyrtari që kishte përgatitur specifikimet dhe termat e referencave kishte marrë pjesë edhe në komisionin për vlerësim të ofertave.

Poashtu, në procesin e prokurimit për "Furnizim me libra për vitin shkollor 2020/2021" kemi vërejtur që zyrtari i cili kishte inicuar procedurën e prokurimit, është përzgjedhur si kryesues i komisionit të negociimit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së njohurive në lidhje me kërkesat për ndarjen e detyrave, mungesa e monitorimit të duhur të procesit nga departamenti i prokurimit, si dhe me arsyen e mungesës së stafit kompetent për vlerësim të ofertave.

Ndikimi Kontrollat jo efektive kanë mundur të përfshirjen e zyrtarëve të njëjtë në dy faza të procesit e që kjo është në kundërshtim me parimet e ndarjes së detyrave si konflikt interesi dhe mund të ndikojë edhe në procesin e vlerësimit duke e përzgjedhur operatorin fitues në mënyrë jo objektive.

Rekomandimi A14 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguron ndarjen e drejtë të detyrave ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Zyrtarët nga njësia kërkuese të cilët janë të përfshirë në hartimin e specifikave nuk duhet të caktohen në vlerësimin e tenderëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19

Buxheti për menaxhimin e emergjencës nga Covid-19 ishte 741,915€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 685,051€. Ndërsa buxheti nga programi i rimëkëmbjes ekonomike ishte 1,291,105€, kurse shpenzimi 316,602€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me pagesat shtesë për mësimdhënës, furnizim me maska, dezinfektimi i shkollave në të cilat është mbajtur mësimi në distancë, ndërsa në Qendrën e Studentëve, e cila ishte shpallur si hapësirë karantinimi, shpenzimet kishin të bënin me furnizim me naftë, furnizim me ushqim, furnizime pastrimi/dezinfektimi, shpenzime për paketime ushqimi për të karantinuarit, kompensim shtesë për stafin etj. Kemi testuar 37 mostra nga të cilat 21 për kompensim shtesë të stafit për punë jashtë orarit dhe 16 nga mallrat dhe shërbimet.

Çështja A15 - Mangësi gjatë përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë

Gjetja

Neni 35.3 i Ligjit të Prokurimit Publik, lidhur me zhvillimin e procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, përcakton që ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht në lidhje me çmimet, afatet e pranimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancionet.

Qendra e Studentëve kishte nënshkruar një kontratë për "Mirëmbajtje Higjienike të Objekteve të QS" për periudhën 29.02.2020-28.02.2023 në vlerë mujore 14,799€, në të cilën ishin të specifikuar punët dhe materialet higjienike që do të përdreshin për pastrim. Krahas kësaj kontrate, QS kishte edhe një kontratë "Furnizim me material Higjienik për nevoja të Mensës në QS" për periudhën 29.01.2020-29.01.2023 në vlerë indikative 81,930€. Për shkak të shpalljes së QS si hapësirë Karantine, QS kishte nënshkruar një kontratë shtesë për "Furnizim me material Higjienik për nevoja të QS, Karantinës dhe Stafit përcjellës" me të njëjtin furnitor përmes procedurës negociuese për periudhën 22.04.2020-22.10.2020 në shumën indikative 121,360€. Në kontratën e re të negociuar me 30 artikuj, 26 prej tyre ishin të njëjtë si produktet me kontratën paraprake, por me çmime më të larta, sa për ilustrim në kontratën e parë produkti "Air Wick aroma te ndryshime për zyrë komplet me aparat paketimi 250ml" ishte kontraktuar me çmim 0.15€ ndërsa në kontratën e dytë 4.35€; "Mbushës për Air Wick Aroma për Aparat 250ml" në kontratën e parë kishte çmimin 0.50€ ndërsa me kontratën e re 2.5€; "Aparat Metali për shampon për duar i kualitetit të lartë 500-750ml" në kontratën e parë ishte kontraktuar me çmim 1.20€, ndërsa në kontratën e dytë 3.80€, etj.

Sipas zyrtarëve të QS-së, kjo kishte ndodhur si rezultat i gjendjes emergjente dhe pandemike, me ç'rast Qendra e Studentëve ishte caktuar si hapësirë Karantine, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) me nr.01/13 të datës 18.03.2020.

Ndikimi Lidhja e kontratës përmes negocimit, me çmime më të larta se sa kontrata aktuale me të njëjtin OE, ndikon në dëmtimin e buxhetit dhe eliminimin e mundësisë së negocimit me më shumë OE, që do të mundësonte marrjen e ofertave potencialisht më të lira.

Rekomandimi A15 Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë ekonomike dhe transparente, duke zbatuar normat ligjore dhe eliminuar mundësinë që produktet e njëjta të furnizohen me kontrata të ndryshme dhe me çmime më të larta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2020, ishte 5,976,949€ apo 1.1 milion më shumë se në vitin paraprak.

Çështja A16 - Mangësi në regjistrat e detyrimeve kontigjente dhe shpalosjen e tyre ne PFV

Gjetja

Rregullorja nr 01/2017 për Pasqyrat Financiare Vjetore të OB, i obligon OB-të që ndër të tjera në pasqyra financiare t'i shpalosin edhe informatat në lidhje me detyrimet kontigjente.

Gjatë testimit të mostrave ne kemi identifikuar tri (3) raste në vlerë totale 68,339€ të cilat gjatë vitit 2020 kishin marrë formë të prerë, ku dy prej tyre ishin paguar dhe një ishte hedhur poshtë nga Gjykata Themelore me arsyetimin se kërkesat në fatura janë të parashkruara-të vjetërsuara.

Po ashtu, në vitin 2013, një qytetar e kishte paditur Ministrinë e Arsimit në Gjykatën Themelore për dëmshpërblim për shkak të lëndimit trupor të shkaktuar nga rënia e xhamave nga ndërtesa e Fakultetit të Arteve, i cili është në kuadër të Universitetit të Prishtinës, organizatë buxhetore e ndarë nga MASHTI. Shuma fillestare që paditësi pretendon ishte 23,504€. Përkundër faktit që e paditura në dokumentin e padisë është ministria, ky rast nuk i takon MASHTI-t dhe si i tillë nuk duhej të ishte pjesë e regjistrat të detyrimeve kontigjente të Ministrisë.

Mangësitë në regjistrat e detyrimeve kontigjente dhe raportimin e tyre në PFV kishin ndodhur si shkak i mos funksionimit të duhur të linjave të komunikimit në mes të zyrës ligjore dhe asaj të financave. Ndërsa, Zyra ligjore, padinë e cila nuk i takon MASHTI-t, e kishte përfshirë në listën e detyrimeve kontigjente pasi padia iu kishte drejtuar kësaj ministrie.

Ndikimi

Paraqitja si detyrime kontigjente e rasteve të mbyllura (me pagesë apo edhe ato të refuzuara nga Gjykata me vendim të prerë), si dhe padive ku shkaktar i dëmeve nuk është Ministria, shkakton mbivlerësim të detyrimeve kontigjente në PFV.

Rekomandimi A16

Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete, për t'i eliminuar dobësitë në menaxhimin e informatave për detyrimet kontigjente, duke inicuar një azhurnim të regjistrat aktual, si dhe të nxisë një bashkëpunim më të afërt dhe efikas mes zyrës se financave dhe asaj ligjore, në mënyrë që informatat e shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të plota.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	76,540,015.00	62,814,499.85	54,198,551.69	62,770,301.03	49,447,600.74
Grante Qeveritare - Buxheti	63,172,996.00	49,132,996.02	44,919,060.26	54,136,375.94	44,820,361.78
Financimi përmes huamarrjes	3,134,454.00	2,067,136.00	1,071,702.78	947,533.86	727,022.70
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,000,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	1,365,271.66	1,104,293.25	873,165.50	669,512.19
Të hyrat vetanake	2,232,565.00	2,232,564.99	937,429.79	1,130,159.22	1,018,083.65
Te hyrat nga AKP-ja	7,000,000.00	6,850,000.00	5,540,372.55	5,329,825.27	1,999,676.75
Donacionet vendore	0.00	83,095.22	25,568.06	23,824.25	20,786.64
Donacionet e jashtme	0.00	1,083,435.96	600,125.00	329,416.99	192,157.03

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 13,725,515€. Ky zvogëlim është rezultat i shkurtimeve buxhetore që kanë ndodhur brenda të gjitha kategorive ekonomike me rishikimin e buxhetit për vitin 2020 në vlerë prej 13,523,338€. Më tutje, zvogëlimi në vlerë 202,177€ është si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje dhe rregullime në kategoritë e shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2020.

Në vitin 2020 MASH ka shpenzuar 86% të buxhetit përfundimtar në 2020 ose € 54,198,552, me një nivel të shpenzimit të njëjtë në raport me buxhetin, sikur në vitin 2019. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	76,540,015.00	62,814,499.85	54,198,551.69	62,770,301.03	49,447,600.74
Pagat dhe mëditjet	19,763,605.00	19,275,333.88	19,162,565.00	18,641,974.55	17,950,176.20
Mallrat dhe shërbimet	16,721,344.00	18,027,640.47	14,490,315.72	20,994,125.83	9,072,900.78
Komunalitë	1,645,459.00	1,132,976.64	759,139.68	1,005,813.59	987,150.90
Subvencionet dhe transferet	8,591,929.00	4,603,208.58	3,977,731.24	2,564,236.95	2,761,002.19
Investimet Kapitale	29,817,678.00	19,775,340.28	15,808,800.05	19,564,150.11	18,676,370.67

Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 488,271€. Ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit të buxhetit për vitin 2020, në vlerë 466,125€, si dhe me vendim të Qeverisë 22,146€. Nga kjo kategori ishte realizuar 99% e buxhetit.


Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 1,306,296€. Fillimisht përmes rishikimit të buxhetit, në këtë kategori kishte zvogëlim të buxhetit për 1,987,000€, ndërsa me vendime të Qeverisë kishte rritje për 3,293,296€. Përkundër rritjes së buxhetit, realizimi në këtë kategori është 80%. Ky mos realizim vjen si shkak i ngecjes së procedurave të prokurimit për blerjen e pajisjeve teknologjike si pjesë e realizimit të Master Planit për zhvillim të mësimin në kushte pandemie, sipas vendimit të qeverisë nr.01/23 për zbatimin e programit të rimëkëmbjes ekonomike. Kontrata nuk kishte arritur të nënshkruhet si rezultat i ankesës së OE në OSHP.

Buxheti për shërbime komunale ishte zvogëluar për 512,482€, ku zvogëlimi me rishikim të buxhetit ishte 492,259€, ndërsa me vendim të Qeverisë 20,223€. Përqindja e realizimit ishte 67%, si rezultat i mos alokimit të mjeteve nga të hyrat të realizuara, në periudhën e fundit të vitit.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,988,720€. Buxheti fillimisht ishte zvogëluar përmes rishikimit të buxhetit, në vlerë 1,936,569€, ndërsa më pas me vendime të Qeverisë në vlerë 2,052,151€. Realizimi i buxhetit ishte 86%, si pasojë e anulimit të dy pagesave nga Thesari.

Buxheti final për investime kapitale, në krahasim me atë fillestar, ishte zvogëluar për 9,042,338€, ku me rishikim të buxhetit kishte zvogëlim prej 8,085,362€, dhe me vendime të Qeverisë zvogëlim të buxhetit në vlerë 956,976€. Realizimi në këtë kategori ishte 80% e buxhetit. Kjo përqindje e realizimit vjen si pasojë e anulimit të një numri të pagesave nga Thesari, pagesa të çertifikuara në muajin dhjetor, për shkak të refuzimit nga sistemi në momentin e arritjes së limitit minimal të lejuar sipas legjislacionit në fuqi për rregullën fiskale të bilancit bankar të shfrytëzuar. Ndërkaq një pjesë e mos realizimit është si rezultat i mos realizimit të fondit të huamarrjes, i cili ishte realizuar vetëm 11% si shkak i ngecjes së procedurave të prokurimit për projektet: Përmirësimi i Sistemit Aktual për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) dhe Blerja e Tabletave për COVID-2019.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020




Shpenzimet për investime kapitale, në raport me dy vitet paraprake kanë pësuar ulje. Krahasuar me vitin 2019, shpenzimet ishin për 3,755,350€ më të ulëta.

Ulje të shpenzimeve në raport me vitet paraprake kishte edhe në mallra dhe shërbime, ku krahasuar me vitin 2019, shpenzimi në këtë kategori ishte më i ulët për 6,503,810€.

Arsyeja e shpenzimit të ulët në këto dy kategori kishte të bëjë me reduktimin e buxhetit përmes ligjit të rishikuar të buxhetit si dhe vendimeve të Qeverisë, si dhe me dështimin e procedurave të prokurimit për projektet e planifikuara, dhe kthimin e pagesave nga Thesari në fund të vitit. Ndërsa trend të rritjes së shpenzimeve, kemi tek kategoria e pagave dhe mëditjeve, me shpenzim më të lartë në vlerë 520,890€ sesa në vitin 2019, si dhe tek kategoria e subvencioneve dhe transfereve, ku në vitin 2020 shpenzimi ishte për 1,413,494€ më i lartë se në vitin 2019.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga MASHTI në 2020 ishin në vlerë 1,839,613€. Ato kanë të bëjnë me participimin e studentëve, akreditimin e programeve akademike si dhe të hyrat nga qiraja. Kemi testuar 10 mostra për teste substanciale dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë, dhe nuk kemi ndonjë çështje për të raportuar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	2,614,699.00	2,175,463.00	1,839,613.13	2,935,178.54	2,675,065.69
Të hyrat jo tatimore	2,614,699.00	2,175,463.00	1,748,691.89	2,882,838.34	2,674,598.04
Të hyrat tjera	0.00	0.00	90,921.24	52,340.20	467.65

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të MASHTI ka rezultuar në 14 rekomandime. MASHTI kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tetë (8) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishte në proces dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende. Për më tepër shih më poshtë Grafikonin 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri përmes mekanizmave përkatës ligjor në dispozicion ¹⁰ të inicioj rishikimin e rregulloreve të universiteteve për kompensimet e komisioneve për një menaxhim efektiv të buxhetit të tyre.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. Edhe këtë vit janë identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri duhet ta adresoj këtë çështje edhe në Qeveri.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. Ministri kishte marrë veprim duke adresuar çështjen në Qeveri, mirepo nga ana e Ministrisë nuk kishte veprime tjera.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete për të zgjidhur çështjen e sistemit dhe riorganizimin të stafit në harmoni me kërkesat ligjore. Funkcionin e njëjtë nuk mund ta ushtrojnë dy punonjës andaj duhet shqyrtuar me seriozitet të gjitha mundësitë për zgjidhje përmes konkurseve për të eliminuar kontestet dhe kostot shtesë.	Në datën 08.07.2020 është formuar komisioni për hartimin e rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MASH. Në dhjetor të viti 2020, MASH ishte në proces të finalizimit të Draft-Rregullores.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Nuk janë marrë masa.	Nuk është adresuar
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të siguroj se për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta zhvillohen procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit, në mënyrë që procesi të jetë transparent.	Është bërë ndërprerja e të gjitha marrëveshjeve për shërbime të veçanta.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri dhe Rektori i Universitetit të Prizrenit duhet të ndërprejnë aplikimin e lidhjes së aneks kontratave dhe pagesave të parregullta si dhe të shqyrtohet mundësia e trajnimit për zyrtarët e prokurimit nga institucionet kompetente pasi që gabimet e tilla tregojnë mungesë të njohurive nga fusha e prokurimit.	Nuk kemi hasur në raste të njëjta të përsëritura	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se plani vjetor për financimin e OJQ-ve raportohet sipas kërkesave ligjore pranë ZKM-së, dhe që janë eliminuar vonesat duke caktuar komisionet përkatëse me kohë për të respektuar afatet e përcaktuara me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve për subvencione.	Nuk kemi hasur në raste të njëjta të përsëritura.	I zbatuar


8.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se me rastin e vlerësimit të tenderëve, komisioni i vlerësimit të marrë për bazë vetëm kriteret e vendosura me dosjen e tenderit duke i shterur të gjitha mundësitë ligjore për marrjen e ofertës më të lirë në mënyrë që buxheti i ministrisë të mos dëmtohet. Po ashtu, në rastet kur mungojnë informatat e plota duhet të aplikohet kërkesa për sqarime me qëllimin e vetëm që të merret oferta me kosto më ekonomike. 18 Kontrata	Menaxhmenti nuk kishte marrë veprime të mjaftueshme për të eliminuar dobësitë në fushën e prokurimit, meqë prapë janë hasur mangësi gjatë vlerësimit të ofertave	Nuk është adresuar
9.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik i përmbushin kriteret për një gjë të tillë. Kjo do duhej aplikuar për të eliminuar qëllimet dhe informatat jo të sakta nga ana e OE-ve.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë auditimit.	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Ministri duhet të themeloj një komision nga ekspertët e fushës së projektit për të vlerësuar mbarëvajtjen e këtij projekti përfshirë edhe vlerësimin e pranimeve të realizuara deri më tani. Po ashtu, duhet të sigurohet që pagesat janë duke u bërë në pajtim me qëllimet e projektit, në përputhje me kornizën rregullative dhe që janë duke u marr kualitativisht produktet e projektit në pajtim me termat e referencës dhe kontratën.	Ministri kishte themeluar komisionin nga ekspertët e fushës së projektit të cilët kishin bërë vlerësimin e punëve të pranuar gjatë vitit 2020.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesat të realizohet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim efektiv me Ministrin e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.	Menaxhmenti kishte bërë kërkesë në MF, për të adresuar çështjen e keq klasifikimit të buxhetuar, por kjo nuk ishte rregulluar për vitin 2020.	Nuk është i aplikueshëm më
12.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë kontrollë efektive në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të ketë një regjistr të plotë të pasurive në çdo kohë. Më tutje, duhet të sigurojë që komisioni pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëj harmonizimin e tij me regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive me të cilat disponon organizata.	Menaxhmenti kishte marrë veprime për të regjistruar pasuritë e identifikuar si të paregjistruara, megjithatë rekomandimi sa i përket inventarizimit dhe sistemit të e-pasurisë nuk është zbatuar tërësisht.	Pjesërisht i zbatuar

13.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.	Menaxhmenti nuk kishte marrë veprime të mjaftueshme për zbatimin e rekomandimit lidhur me pagesën e faturave brenda afatit, meqë në tri raste janë hasur vonesa në pagesën e obligimeve	Nuk është adresuar
14.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të marrë veprime për funksionalizimin efektiv të KA, në mënyrë që të sigurohet se roli dhe misioni i KA në ministri po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë.	Në qershor të vitit 2020, është themeluar Komiteti i Auditimit, në përbërje prej tre anëtarësh.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Ministri, në bashkëpunim me Zyrтарin Kryesor Financiar duhet të siguroj që të qartësohen me Thesarin të gjitha çështjet në lidhje me pagesat, për tu siguruar që njohja e shpenzimeve dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare të bëhet vetëm pas konfirmimit të daljeve të mjeteve nga llogaria bankare.
2.	Baza për opinion	Ministri, duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, të barten në regjistrat e komunave të cilat i kanë nën administrim këto shkolla, si dhe bartja e pronësisë të bëhet me të gjitha procedurat formale.
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të dhënat kontabël të jenë të harmonizuara me gjendjen faktike të borxheve, dhe me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare të shpalos të gjitha transaksionet që kanë rezultuar me pranim të mallrave apo shërbimeve, dhe për të cilat pritet dalje e sigurt e parasë.
4.	Baza për opinion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për heqjen e pasurive të dyfishuara si dhe aplikimin e zhvlerësimit të pasurive në e-pasuri në mënyrë që ky regjistër të reflektoj gjendjen reale të pasurive jokapitale.
5.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se nuk do të paguhen kompensimet për stafin e brendshëm të angazhuar në grupe punuese dhe komisione, përderisa angazhimet kryhen brenda orarit të rregullt të punës.
7.	Baza për konkluzion	Ministri, në bashkëpunim me Rektorët e Universitetit të Pejës dhe Universitetit të Gjilanit, duhet t'i shqyrtoj në rastet e mësipërme dhe të parandalojnë rastet tjera që paramasat dhe pozicionet e punimeve të ndryshohen pa aprovimet e kërkuara sipas rregullave dhe procedurave të prokurimit.
8.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj që kontratat duhet të nënshkruhet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë së tenderëve.

9.	Baza për konkluzion	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që para nënshkrimit të kontratave, të sigurohet se ka fonde të mjaftueshme në pajtim me ndarjet buxhetore, dhe se informatat financiare në DNPDF, duhet të rikonfirmohen para publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës.
10.	Baza për konkluzion	Ministri, duhet të siguroj një mbikëqyrje më strikte ndaj realizimit të projekteve, duke kërkuar që për çdo kontratë të raportohet rregullisht ecuria e realizimit të projektit në përputhje me planin detal dhe në rast të zgjatjes së periudhës së realizimit, kjo të bëhet vetëm me aprovimet përkatëse me shkrim ku definojnë afatet e qarta të përfundimit të projekteve.
11.	Baza për konkluzion	Ministri, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit të përfundoj me kohë, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, dhe të bëhet krahasimi mes gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë, si dhe të gjitha pasuritë jokapitale të regjistrohen dhe raportohen përmes sistemit e-pasuria, në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.
12.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Rektoren e Universitetit të Pejës dhe Drejtorin e Qendrës së Studentëve duhet të sigurojnë se vlerësimi i tenderëve bëhet në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.
13.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh.
14.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj se asnjë kontratë e cila ka për qëllim realizimin e saj brenda vitit fiskal, nuk do të nënshkruhet pa siguruar zotimin e mjaftueshëm të fondeve për realizimin e saj.
15.	Pagat dhe mëditjet	Ministri përmes mekanizmave përkatës ligjor në dispozicion duhet të inicioj rishikimin e rregulloreve të universiteteve për kompensimin e komisioneve të brendshme në mënyrë që ato të jetë në harmoni me normat e përgjithshme ligjore të menaxhimit të financave publike.
16.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar vijueshmërinë e rregullt të këtyre punonjësve në vendin e punës, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.
17.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve dhe Rektoret e Universiteteve, duhet të forcojnë kontrollin e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojnë zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.
18.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkallimet e furnizimeve. Në rastet kur tejkallimi i porosive për artikuj arrin shkallën 30% mbi sasinë indikative, kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.
19.	Investimet kapitale	Ministri, duhet të siguroj se zyra e prokurimit, shqyrton me përpikëri përmbushjen e kërkesave nga operatorët ekonomik, me rastin e nënshkrimit të kontratave, duke u siguruar që siguria e ekzekutimit e mbulon tërë kohëzgjatjen e kontratës.
20.	Çështjet e përbashkëta	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguron ndarjen e drejtë të detyrave ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Zyrtarët nga njëzia kërkuese të cilët janë të përfshirë në hartimin e specifikave nuk duhet të caktohen në vlerësimin e tenderëve.
21.	Covid - 19	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë ekonomike dhe transparente, duke zbatuar normat ligjore dhe eliminuar mundësinë që produktet e njëjta të furnizohen me kontrata të ndryshme dhe me çmime më të larta.
22.	Detyrimet Kontigjente	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete, për t'i eliminuar dobësitë në menaxhimin e informatave për detyrimet kontigjente, duke inicuar një azhurnim të regjistrit aktual, si dhe të nxisë një bashkëpunim më të afërt dhe efikas mes zyrës së financave dhe asaj ligjore, në mënyrë që informatat e shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të plota.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm

Bujar Bajraktari, Udhëheqës i Auditimit



Erëmira Bytyqi - Pllana, Udhëheqëse e ekipit




Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Natyra Kasumaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

					
Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo Qeveria –Vlada-Government Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelaria e Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary					
<h3>LETËR E KONFIRMIMIT</h3> <p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p>					
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit					
Të nderuar,					
Përmes kësaj shkrimesh, konfirmoj se:					
<ul style="list-style-type: none"> • kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave Financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); • pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet, ndërsa komentet për përmbajtjen e raportit i kemi ofruar gjatë procesit; • brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre. 					
Fadilë Dyla  Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Data: 27 korrik, 2021 					

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹¹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Ndertimi i shkolles Gushavc, Mitrovice në vlerë 665,442Eur; Ndertimi i shkolles Kryshevc Peje në vlerë 459,491Eur; Ndertimi i shkolles Llaushe Podujeve në vlerë 432,396Eur; Ndertimi i shkolles Vraniq Suhareke në vlerë 1,182,931Eur; Ndertimi i shkolles Doberdolan Suhareke në vlerë 557,174Eur; Ndertimi i shkolles profesionale ne Ferizaj në vlerë 665,442Eur; Ndërtimi i sallës së sporteve Vushtrri në vlerë 237,460Eur
- ⁶ Agjencia e Kosoves per Akreditim; Autoriteti Kombetar I Kualifikimeve; Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"; Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren; Universiteti i Shkencave të Aplikuara "Ferizaj".
- ⁷ Universiteti Ukshin Hoti - Prizren, Universiteti Fehmi Agani - Gjakovë, Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj dhe Universiteti "Kadri Zeka"- Gjilan
- ⁸ Universiteti Fehmi Agani - Gjakovë, Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj dhe Universiteti "Kadri Zeka"- Gjilan,
- ⁹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.